



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA TIRANË

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “K A C D E D J A” shpk

**Adresa:** Tirane, Rruga “Don Bosko”, Pallati Meld, kati i dytë

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”, “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i tregut agroushqimor të Tiranës”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-55568-12-30-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i tregut agroushqimor të Tiranës”.

Fondi limit: **28,632,949.47** (njëzetë e tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e dyzetë e nëntë pikë dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: **3(tre)** muaj kalendarik.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Nr.2, datë 9 Janar 2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ELDA VL” shpk NUIS K67106202W  
Vlera e ofertës: 0 (zero) lekë pa TVSH
2. Operatori ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk NUIS L78006801F  
Vlera e ofertës: 21,140,599 (njëzetë e një milion e njëqind e dyzetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “NIKA” shpk NUIS J76705047U  
Vlera e ofertës: 22,212,193 (njëzetë e dy milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë tre) lekë pa TVSH.
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “EURO-ALB” shpk & “M U R A T I” shpk NUIS K66613407H & NUIS  
J66702413V  
Vlera e ofertës: 23,559,398.81 (njëzetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk NUIS K51712017A

Vlera e ofertës: 23,765,001.40 (njëzetë e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e një pikë dyzetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik "BE - IS" shpk NUIS K71412003A

Vlera e ofertës: 25,523,059 (njëzetë e pesë milion e pesëqind e njëzetë e tre mijë e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik "T & XH" shpk NUIS L72121504I

Vlera e ofertës: 26,379,867.8 (njëzetë e gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pike tete) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "ELDA-VL" shpk NUIS K67106202W

Operatori ekonomik "ELDA-VL" shpk nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacioni i kërkuar cka bie në kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve Standarte të Tenderit si dhe kërkesat ligjore-ekonomike-teknike të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Operatori ekonomik "L.T.E CONSTRUCTION" shpk NUIS  
L78006801F

Operatori ekonomik "LTE Construction" shpk nuk plotëson pikën 7.3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit teknik ndertimi, elektrikist, hidraulik dhe mekanik, emrin, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse. Ndersa per punonjesit manovrator.....*" pasi per punonjesit teknik ndertimi, teknik mekanik, punonjes betonues dhe manovratorë, nuk jane deklaruar numrat e kontratave individuale të punës, si dhe numrat dhe titujt e kualifikimit për diplomën përkatëse.

3. Operatori ekonomik "NIKA" shpk NUIS J76705047U

Operatori ekonomik "NIKA" shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore .....*" pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit nuk është deklaruar punonjësi buldozerist.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "EURO-ALB" shpk & "M U R A T I" shpk  
NUIS K66613407H & NUIS J66702413V

Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Euro-ALB" shpk & "MURATI" shpk nuk plotëson pikën 7.3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: "*Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit teknik ndertimi, elektrikist, hidraulik dhe mekanik, emrin, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse. Ndersa per punonjesit manovrator.....*" pasi per punonjesit teknik ndertimi, teknik mekanik, punonjes betonues dhe manovratorë, nuk jane deklaruar numrat e kontratave individuale të punës, si dhe numrat dhe titujt e kualifikimit për diplomën përkatëse.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “K A C D E D J A” shpk, me adresë: Tirane, Rruga “Don Bosko”, Pallati Meld, kati i dytë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 23,765,001.40 (njëzetë e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e një pikë dyzetë) lekë pa tvsh është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 25,523,059.00 lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO